



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

Drejtoria Komunale e Arsimit

Datë: 06.07.2023

Nr. i prot.: 04/1056

Vendi: Rahovec

Bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Udhëzimit Administrativ 19/18 të datës 07.12.2018, për Themelimin dhe Funkcionimin e Qendrave Mësimore, Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të komunës së Rahovecit dhe OJQ "Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve të datës 05.11.2019, si dhe kërkesave e nevojave që dalin nga kjo marrëveshje për plotësimin e vendeve të lira të punës për tutor në Qendrën Mësimore në SHFMU "4 Dëshmorët" në Ratkoc, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec,
RISHPALL:

KONKURS PËR VENDE TË LIRA TË PUNËS

Titulli i vendit të punës: **Tutor/e**

Vendi i punës: **SHFMU "4 Dëshmorët" në Ratkoc**

Numri i pozitave: **2 (dy)**

Orari i punës: **40 orë në javë**

Afati i aplikimit: **07.08.2023 - 21.08.2023**

Kualifikimet e kërkuara:

- Diplomë fakulteti;
- Njohuri të punës me kompjuter;
- Përvojë pune në fushën e arsimit (së paku tri vite);
- Përvojë pune me fëmijë të komuniteteve;
- Shkathtësi komunikimi.

Përshkrimi i vendit të punës:

- Organizimi i mësimit plotësues pas orarit të rregullt të mësimit në shkollë publike përmes përshtatjes së metodave të mësimit bazuar në nevojat e fëmijëve;
- Ofrimi i mbështetjes emocionale për Romët, Ashklalinjtë, Egjiptianët dhe fëmijët e tjerë të cenuar me qëllim të ndërtimit dhe zhvillimit të vetë-respektit, individualitetit, aftësive komunikuese si dhe kompetencave të tyre;
- Sigurimi i mbështetjes akademike/profesionale të fëmijëve që përballen me vështirësi në mësim-nxënie me qëllim të përmbushjes së kërkesave të kurrikulës;
- Përdorimi i qasjes individuale në udhëheqjen e procesit të të mësuarit për zhvillimin dhe forcimin e karakteristikave si: aftësia e të dëgjuarit, ndjeshmëria, mirësia etj. Si shkathtësi të jetesës të cilat do të kenë ndikim afatgjatë në mirëqenien psiko-sociale të fëmijëve;
- Organizimi i programit edukativ të mësimit plotësues bazuar në kurrikulë;
- Motivimi i fëmijëve për të përmirësuar rezultatet në mësim-nxënie dhe zhvillimin e sjelljeve pozitive sociale me fëmijët e tjerë brenda shkollës dhe jashtë saj;
- Shkëmbimin e përvojave me mësimitdhënësit e rregullt, udhëheqjen e shkollës dhe përfaqësuesit e Drejtorisë Komunale për Arsim (DKA);
- Mbajtja e dëshmimeve mbi vijueshmërinë dhe përmirësimin e rezultateve të mësimit-nxënies së fëmijëve mbi bazën e të dhënave individuale;
- Përpilimin e raporteve mujore, pasqyrën e ditëve të realizuara të punës dhe të dhëna të rregullta për fëmijët dhe ofrimin e tyre drejtorisë së shkollës;
- Organizimi i takimeve të rregullta individuale përmes vizitave me prindër në familjet e tyre si dhe takime individuale dhe grupe me prindër në shkollë me qëllim të identifikimit të mbështetjes shtesë të nevojshme për fëmijët dhe familjet e tyre;
- Përcjellja e rasteve të fëmijëve që tregojnë shenja të vijueshmërisë jo të rregullt dhe t'i raportojnë ato në Ekipin për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes brenda shkollës;
- Identifikimi dhe referimi i rasteve të fëmijëve dhe familjeve në nevojë dhe në rrezik në drejtorinë e shkollës, Qendrën për Punë Sociale dhe Grupin Këshillues të Komunitetit;
- Numri i fëmijëve për një klasë të mësimit plotësues është nga 25-30 fëmijë.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Formulari i aplikimit (i cili merret dhe dorëzohet në DKA);
- Biografia personale (CV e formatit Europian);
- Letër motivuese;
- Diplomat e kualifikimit (kopje e noterizuar);
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmitë mbi përvojën e punës;
- Ekstrakti i lindjes;
- Dëshminë që nuk jeni nën hetime;
- Certifikatën shëndetësore (ofrohet pas pranimit të kandidatëve).

Afati i konkursit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike, nga data, 07.08.2023 deri më datë, 21.08.2023 dhe është i publikuar në tabelën e shpalljeve të DKA-së dhe në ueb faqen e komunës së Rahovecit.

Mënyra e aplikimit:

Mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës. Të gjithë kandidatët e interesuar, aplikacionet mund t'i marrin në formë fizike në Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA) apo t'i shkarkojnë ato nga <https://konkursi.rks-gov.net>, të plotësuar së bashku me dokumentet e tjera t'i dërozojnë në zyrat e DKA-së në Rahovec.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së testit dhe intervistave, kandidatët do të informohen përmes njoftimeve të cilat do të publikohen në ueb faqen e komunës së Rahovecit dhe në tabelën e shpalljeve të DKA-së në Rahovec.

